



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 408/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Fejzullah Rexhepi, kryesues, Adnan Konushevi dhe Faton Ademi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës Branimir Stojanoviq nga subjekti politik G.I Srpska Lista, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 01.07.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si e bazuar ankesa e Kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Branimir Stojanoviq nga subjekti politik G.I Srpska Lista.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet për të gjitha subjektet politike dhe të gjithë kandidatëve të tyre në Vendvotimin: VV 3405E/01R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të kutive të votimeve në Vendvotimet si në pikën - II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 30.06.2017, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Branimir Stojanoviq nga subjekti politik G.I Srpska Lista, me të cilën pretendon se gjatë publikimit të rezultateve përfundimtare gabimisht është vërtetuar gjendja faktike dhe është bërë një lëshim gjatë futjes së rezultateve të sakta për kandidatët e GI Srpska Lista në vendvotimin 3405E/01R në komunën e Graçanicës. Parashtruesi i ankesës thekson se duke e shikuar gjendjen faktike nga procesverbali në këtë vendvotim është vërtetuar se GI Srpska Lista si subjekt politik ka fituar 197 vota, e në rezultatin përfundimtar del se ka fituar 116 vota, ku ka mospërputhje në mes të votave të kandidatëve të GI Srpska Lista.

Parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP-i që kjo ankesë të pranohet si e bazuar dhe ti urdhërohet KQZ-së që të vërtetojë gjendjen e saktë faktike

Si prova materiale ka bashkangjitur Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularët e Përputhjes së të dhënave për vendvotimin e lartcekur.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

ankesa është e bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lendes, si dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, siç rezulton edhe nga provat e ofruara si dëshmi nga vete pala ankuese, andaj mbi këtë baze dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për të gjitha subjektet politike dhe të gjithë kandidatët e tyre për vendvotimin 3405E/01R, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim të bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr. 408/2017 më datën 01.07.2017.



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.